

**THE OPEN GOVERNMENT PARTNERSHIP
NATIONAL ACTION PLAN FOR ALBANIA
2026 – 2030
CONSULTATION SUMMARY 1**



CONSULTATION 1

Consultation Details

Policy Goal Focus

Angazhime të propozuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit janë:

1. Forcimi i kapaciteteve teknike të strukturave institucionale me kompetenca parandalimi të korrupsionit;
2. Vlerësimi i riskut të korrupsionit në administratën publike me fokus sektorët vulnerabël sipas SNKK;
3. Forcimi i bashkëpunimit midis sektorit publik dhe privat në uljen e incidencës së korrupsionit;
4. Përmirësimi i ndërveprimit të autoriteteve publike në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe grupet e interesit;
5. Zbatimi i kurrikulës së integritetit dhe informimit për luftën kundër korrupsionit në arsimin parauniversitar.

Lead Focal Point Institution

Znj. Rovena Prega / Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave në Fushën Antikorrupsion, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit

Znj. Viktoria Spiro / Përgjegjës sektori i monitorimit dhe koordinimit të politikave prioritare, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit

Z. Hener Shanaj / Specialist i sektorit të monitorimit dhe koordinimit të politikave prioritare, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit

Date

5.03.2026

Consultation Meeting Number

1

I. Objective of Consultation Meeting

What was the aim of this consultation?
Please answer for all that apply

Details:

Takimi i parë synoi të bashkëbisedojë me të gjithë përfaqësuesit e OSHC-ve të thirrura në takim, gjithashtu të përfshira në plotësimin dhe ndjekjen e pyetësorit të ndarë për plotësim si pjesë e fazës së parë të procesit, lidhur me procesin e bashkë-bërjes në kuadër të PKV, 2026-2030. Takimi garantoj përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile, në hartimin dhe konsolidimin e komponentit të planit kombëtar të PQH, me qëllim marrjen e komenteve dhe të propozimeve konkrete lidhur me konceptimin

	<p>e masave dhe aktiviteteve të reja në funksion të angazhimit të propozuar.</p> <p>Qëllimi i konsultimit ishte gjithashtu diskutimi mbi përmbajtjen dhe gjetjet e pyetësorit për përcaktimin e masave prioritare të DPAK në PKV 2026-2030 dhe të rolit të përfshirjes së OSHC-ve në to.</p>
<p>(i) Introduce stakeholders to the proposed policy goal</p>	<p><input checked="" type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>DPAK në kuadër të detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi i Shqipërisë në Partneritetin për Qeverisjen e Hapur (këtu e tutje “PQH” ose “OGP”), nisur nga fusha e saj e përgjegjësisë ka propozuar angazhime për secilën fushë si më poshtë:</p> <p>Lufta kundër korrupsionit, përbën një nga prioritetet kryesore të politikave publike në Republikën e Shqipërisë dhe është e reflektuar në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, e cila përcakton objektivat dhe masat kryesore për forcimin e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike. Në relevancë me këtë kuadër strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit prezantoi para pjesëmarrësve në takim fushat ku synohet ndërhyrja përmes angazhimeve të mundshme në kuadër të Planit të Veprimit të OGP, duke i orientuar ato në përputhje me prioritetet dhe instrumentet e parashikuara në strategji.</p> <p>Propozimet e paraqitura nga DPAK lidhen veçanërisht me forcimin e mekanizmave të parandalimit të korrupsionit dhe zhvillimin e instrumenteve të integritetit në administratën publike, përmes rritjes së kapaciteteve teknike të strukturave institucionale, avancimit të vlerësimit të riskut të korrupsionit në sektorët më vulnerabël, si dhe përmirësimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërsektorial. Gjithashtu, në përputhje me qasjen e strategjisë për një përfshirje më të gjerë të aktorëve shoqërorë në politikën e integritetit, angazhimet e propozuara synojnë të forcojnë bashkëpunimin midis sektorit publik dhe atij privat, të rrisin rolin e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe të promovojnë edukimin për integritetin dhe ndërgjegjësimin kundër korrupsionit, përfshirë në sistemin arsimor parauniversitar.</p> <p>Sipas parimeve dhe standarteve të PQH, për një qeverisje të hapur, i cili bazohet në një proces gjithëpërfshirës, të drejtë dhe transparent me të gjitha grupet e interesit, si dhe në përputhje me metodologjinë e ndjekur nga institucioni ynë mbi hartimin e dokumentit politik, pjesëmarrësit janë njoftuar paraprakisht për qëllimin e takimit i cili vjen si një proces në vijim të ndjekjes dhe analizimit të të</p>

	<p>dhënave të pyetësorit të ndarë dhe plotësuar për këtë qëllim. Bashkëlidhur agjenda e ndarë.</p> <p>Për këtë qëllim, DPAK në përmbushje të detyrave funksionale që rrjedhin nga ky proces, pas hartimit të pyetësorit, shpërndarjes dhe publikimit të tij online, marrjes së të dhënave dhe analizimit të tyre, prezantoi ato. Për këtë qëllim u përgatit edhe një material prezantimit PPT, bashkëlidhur këtij raporti.</p> <p>Propozimet e DPAK lidhen me adresimin e problematikave të ndryshme me qëllim nxitjen e transparencën qeveritare, për të rritur pjesëmarrjen qytetare në jetën publike, si dhe për të luftuar fenomenin e korrupsionit në të gjitha nivelet e ekspozimit të tij. Gjithashtu ndër propozimet e DPAK janë edhe çështje që lidhen me mekanizmat me efekte parandalimit të korrupsionit dhe që ndërlidhen me dokumente strategjike të fushës, siç është edhe Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.</p>
<p>(ii) Introduce stakeholders to the OGP process</p>	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Po. Në takimin e parë online konsultativ janë ftuar rreth 65 përfaqësues, të organizatave të shoqërisë civile, që kanë veprimtari të fushës antikorrupsioni, të cilëve iu dha informacioni i detajuar për procesin e bashkë-hartimit të PKV 2026-2030 të OGP, si dhe njohja me gjetjet dhe rezultatet e pyetësorit për angazhimin “Lufta kundër Korrupsionit” si pjesë e procesit të bashkë-bërjes së Planit Kombëtar të Veprimit, 2026-2030.</p> <p>Për këtë qëllim u përgatit edhe një material prezantimi PPT, bashkëlidhur këtij raporti.</p>
<p>(iii) Explain the feedback tools for stakeholders</p>	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Në Takimin e parë Konsultativ, i mbajtur Online nëpërmjet platformës Microsoft Teams, znj. Rovena Pregarja / Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave në Fushën Antikorrupsion, dha një prezantim të detajuar të procesit të OGP, si dhe të detyrimeve dhe angazhimeve konkrete për komponentin respektiv: Lufta kundër Korrupsionit. Link i takimit ishte: https://teams.microsoft.com/meet/32591174333738?p=JP6SHE3dTcYwjlvT2C</p> <p>Pjesëmarrësve në takim iu dha mundësia për të pyetur dhe për të komentuar rreth gjetjeve të pyetësorit</p> <p>Pyetësi me gjetjet, në kuadër të procesit të bashkë-bërjes së masave prioritare të angazhimeve të Planit Kombëtar të Veprimit, 2026-2030, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (en: OGP), u shpërnda, paraprakisht nëpërmjet emailit dhe u publikua në</p>

	<p>faqën zyrtare të DPAK, në rrjetet sociale Facebook, LinkedIn dhe Instagraf të DPAK, dhe në platformën rrjetiantikorupsion.al.</p> <p>https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSfyI6eT8Wjd_JP8kQqGAXxGHYfwXWVMDK0fWx54PpwDKTR</p> <p>Të dhënat e analizuara të pyetësorit u bënë pjesë e slideve të prezantimit të përgatitur në takim.</p>
(iv) Brainstorm ideas with stakeholders	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Takimi konsultativ 1, pati ide dhe mendime konkrete për përmirësimin e angazhimeve të sugjeruara nga DPAK, nga pjesëmarrësit në të, dhe propozime të reja siç përmenden: analiza e vlerësimeve të riskut në sektorë publik-privatë, vlerësimi i kuadrit ligjor (hapësirave për korrupsion që ligjet mund të krijojnë), mekanizmat e Pakteve të Integritetit, apo ndërveprimi organe ligjzbatuese – shoqëri civile për raste korrupsioni dhe denoncimesh për korrupsion.</p>
(v) Develop further details (milestones, etc.) for ideas	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Takimi konsultativ 1, pjesëmarrësve iu prezantuan elementë më të detajuar të ideve të propozuara, duke përfshirë veprimet kryesore (milestones) që mund të përfshihen në angazhimet e Planit të Veprimit të OGP, për komponentin tonë. Këto veprime u diskutuan me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të propozimeve dhe identifikimin e hapave konkretë për zbatimin e tyre, në përputhje me parimet e qeverisjes së hapur dhe me prioritetet e politikave antikorrupsion. Diskutimi u fokusua veçanërisht në forcimin e sistemeve të integritetit institucional përmes hartimit dhe zbatimit të planeve të integritetit në institucionet publike prioritare, përfshirë ndërmarrjet shtetërore, si dhe në rritjen e kapaciteteve të drejtuesve institucionalë dhe strukturave përgjegjëse për integritetin. Gjithashtu, u trajtua nevoja për publikimin e planeve të integritetit dhe raporteve të progresit në formate të hapura të të dhënave, me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.</p> <p>Në vijim, u përmendën edhe përfshirja e masave që lidhen me monitorimin e risqeve të kapjes së politikave dhe procesit legjislativ, përmes analizës sistematike të proceseve rregullatore dhe zhvillimit të treguesve dhe mjeteve analitike për identifikimin e risqeve të korrupsionit dhe ndikimit të padrejtë në vendimmarrje. Njëkohësisht, u prezantuan propozime për rritjen e transparencës së aktiviteteve të lobimit, përmirësimin e transparencës në prokurimet publike dhe partneritetet publike-private, si dhe për forcimin e transparencës mbi pronësinë përfituese të kompanive që marrin pjesë në kontratat publike. Këto masa përfshijnë publikimin e</p>

	regjistrave dhe të dhënave përkatëse në formate të hapura, analizimin e risqeve të korrupsionit dhe konfliktit të interesit në kontraktimin publik, si dhe lidhjen e të dhënave mbi pronësinë përfituese me sistemet e prokurimit, me qëllim identifikimin dhe parandalimin e risqeve të mundshme të korrupsionit.
(vi) Gather feedback on proposed policy goals	<input type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes Takimi konsultativ 1, ishte në format shpjegues për të gjithë pjesëmarrësit, lidhur me pyetësonin i hartuar në bazë të angazhimit nga DPAK dhe rezultatet e tij. Në vijim të prezantimit, pjesëmarrësit patën mundësinë të ndajnë komente, sugjerime dhe propozime konkrete lidhur me angazhimet e propozuara dhe drejtimit e mundshme të zhvillimit të tyre. Kontributet e marra nga organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë pjesëmarrës do të merren në konsideratë gjatë fazës së mëtejshme të hartimit dhe përpunimit të angazhimeve që do të përfshihen në Planin e Veprimit të OGP.
(vii) Prioritize proposed policy goals	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes Do të vijojë procesi konkret në takimin e dytë, të paranoftuar data e tij.
(viii) Other (provide details)	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes
II. Methodology	
What was the format of the meeting? How were stakeholders able to participate?	Takimi 1 Konsultativ u organizua Online, i hapur për të gjithë dhe interaktiv. Microsoft Teams meeting Meeting ID https://teams.microsoft.com/meet/32591174333738?p=JP6SHE3dTcYwjlvt2C
(i) Presentations	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Për këtë qëllim i përgatit në agjendë e shpërndarë paraprakisht me pika: <ul style="list-style-type: none"> - Njohja me gjetjet dhe rezultatet e pyetësonit për angazhimin “Lufta kundër Korrupsionit” si pjesë e procesit të bashkë-bërjes së Planit Kombëtar të Veprimit, 2026-2030. - Diskutime dhe propozime nga të pranishmit.

	<p>Ndarja e rolit të tyre përgjatë procesit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmbledhje e takimit dhe ndarja e detyrave. <p>Gjithashtu u përgatit një prezantim në PPT, si bashkëlidhur.</p>
(ii) Discussion / Feedback from stakeholders	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Gjatë takimit u dakordësua që çdo propozim i mundshëm të dërgohet elektronikisht, me shkrim, në adresat e kontaktit dhe u paranoftua edhe data e ardhshme takimit të dytë, 17 mars 2026, në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, për të konsoliduar përmbajtjen e planit të veprimit. me qëllim caktimin e angazhimeve prioritare të PKV 2026-2030.</p>
(iii) Questions and answers	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Gjatë takimit u zhvillua një sesion i hapur pyetje&përgjigje, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të kërkonin sqarime dhe të diskutonin mbi propozimet e paraqitura.</p> <p>Në këtë kuadër, u shkëmbyen komente dhe sugjerime nga përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë pjesëmarrës, të cilat u mbajtën në konsideratë si feedback për zhvillimin e mëtejshëm të angazhimeve.</p>
(iv) Brainstorming	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Pjesëmarrësve iu dha mundësia për të diskutuar mbi propozime dhe mendime mbi Komponentin Lufta Kundër Korrupsionit.</p> <p>OSHC adresuan rekomandime të ndryshme, por në këtë fazë të procesit nuk u përcaktuan masat pprfundimtare të angazhimit dhe u dakordësua për në takimin e radhës, datë 17 mars 2026 të finalizohet ky proces.</p>
Stakeholder Selection	Details
(i) How were stakeholders selected?	<p>Pjesëmarrësit u përzgjedhën në kuadër të bashkëpunimit që ka DPAK, gjatë procesit të hartimit të politikave në fushën e antikorrupsionit, me OSHC, veprimtaria e tyre lidhet me këto dy fusha.</p> <p>Gjithashtu, pjesëmarrësit patën mundësinë të ndiqnin njoftimet online, në faqen e internetit të DPAK, në rrjetet sociale të DPAK dhe në platformën e shoqërisë civile www.rrjetiantikorrupsion.al.</p>

<p>(ii) How were stakeholders contacted?</p>	<p>Palët e interesuara u ftuan të ishin pjesë e këtij procesi në rrugë elektronike (email,website,rrjete sociale dhe rrjetiantikorruption.al).</p> <p>Ftesa u shoqërua edhe me agjendën e takimit, si dhe u njoftuan për plotësimin e pyetësorit dhe mënyrat e aksesimit të tij.</p>
<p>(iii) How many stakeholders were contacted?</p>	<p>65 me email.</p> <p>Të gjithë anëtarët e regjistruar në rrjetiantikorruption.al.</p>
<p>(iv) Was the consultation announced publically? (via websites, social media, etc.)</p>	<p>Po. Procesi i parakonsultimit mbi plotësimin e Pyetësorit është njoftuar në faqen zyrtare të DPAK.</p> <p>Njoftimi është kryer gjithashtu në rrugë elektronike/via-email nga adresa zyrtare e Drejtorit të Zbatimit të Politikave në Fushën Antikorruption.</p> <p>Linket e publikimit janë:</p> <p>Pyetësori:https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSfy16eT8Wjd_JP8kQqGAXxGHYfwXWVMDK0fWx54PpwDKTRibA/viewform</p> <p>Njoftimi në website DPAK: https://antikorrupsioni.gov.al/pyetesor-ne-kuader-te-procesit-te-bashke-berjes-se-masave-prioritare-te-angazhimeve-te-planit-kombetar-te-veprimit-2026-2030-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur-komponenti-lufta-kunder-korru/</p> <p>Njoftimi në rrjete sociale facebook dhe instagram: https://www.facebook.com/100089045846232/posts/b%C3%ABhuni-pjes%C3%AB-e-bashk%C3%AB-krijimit-t%C3%AB-planit-t%C3%AB-ri-komb%C3%ABtar-t%C3%AB-veprimit-p%C3%ABr-partneri/950924414552411/</p> <p>https://www.instagram.com/drejtoriaepergjithshmeak/</p> <p>Shpallja në platformën rrjetiantikorruption.al: https://rrjetiantikorruption.al/forum/konsulto/merrni-pjese-ne-pyetesor/</p>
<p>(v) Were stakeholders reminded?</p>	<p>Po. Palët e interesuara dhe të ftuara në këtë proces janë rikujtuar në rrugë elektronike/ via- e-mail.</p> <p>E-mail për njoftim të plotësimit të pyetësorit, në ditën e fundit të afatit për plotësimin e tij 23.02.2026.</p> <p>E-mail kujtues për zhvillimin e takimit të datës 5.03.2026.</p>

III. Results/ Findings	
Stakeholder Contributions	Details
(i) How many stakeholders attended?	18 pjesëmarrës
(ii) Did stakeholders contribute?	Po.
(iii) Main issues identified by stakeholders	Takimi ishte konsultativ dhe gjatë takimit palëve prezent iu dhanë këshilla dhe kërkesa për propozime dhe përfshirje në masat e angazhimit të PKV 2026-2030.
(iv) Main recommendations from stakeholders?	<p>Takimi i Konsultativ, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë pjesëmarrës ndanë rekomandime dhe komente paraprake lidhur me aktivitetet e angazhimeve në kuadër të Planit të Veprimit të OGP. Diskutimi u fokusua në rëndësinë e forcimit të mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike, si dhe në nevojën për rritjen e rolit të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të interesit në monitorimin e politikave dhe proceseve vendimmarrëse.</p> <p>Gjithashtu, pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e publikimit të të dhënave në formate të hapura, përmirësimit të transparencës në fusha me risk më të lartë korrupsioni, si dhe zhvillimit të mekanizmave që nxisin bashkëpunimin midis institucioneve publike, sektorit privat dhe shoqërisë civile në promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit.</p> <p>Këto propozime në formën e rekomandimeve do të merren në konsideratë në fazat e mëtejshme të hartimit të angazhimeve.</p>
IV. Shortcomings Identified & Preparations for Next Consultation	
	Details
(i) Limitations in stakeholder attendance	<p>Jo.</p> <p>U ftuan rreth 65 përfaqësues nga OSHC në rrugë elektronike (email) me eksperiencë të ndryshme në fushë.</p>
(ii) Limitations in stakeholder participation	<p>Jo.</p> <p>Organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e institucioneve të ftuar në proces ishin 18 nga 65 të ftuar.</p>
(iii) What can be done to improve attendance?	Për të rritur pjesëmarrjen në takimet e ardhshme konsultative, edhe më të kënaqshme, rekomandohet forcimi i komunikimit dhe njoftimit paraprak me organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë të interesit, duke përdorur kanale të ndryshme informimi dhe duke siguruar kohë të mjaftueshme për planifikimin e pjesëmarrjes.

	Gjithashtu, mund të konsiderohet organizimi i takimeve në formate hibride (fizike dhe online), me qëllim lehtësimin e përfshirjes dhe kontributit të një numri më të madh pjesëmarrësish.
(iv) What can be done to improve participation in the next meeting?	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i një ure të qëndrueshme komunikimi dhe bashkëpunimi midis aktorëve të interesuar dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, me qëllim nxitjen e kontributeve dhe propozimeve konkrete për përmirësimin e angazhimeve në fushat përkatëse; - Inkurajimi i pjesëmarrjes përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me palët e interesit dhe theksimit të rëndësisë së rolit të tyre në procesin e bashkë-bërjes së angazhimeve në kuadër të OGP; - Ndarja paraprake e materialeve informuese dhe e propozimeve për diskutim, për të lehtësuar përgatitjen dhe kontributin e pjesëmarrësve në takimet konsultative; - Përdorimi i kanaleve të ndryshme të komunikimit dhe mundësisë së pjesëmarrjes në format online ose hibride, me qëllim përfshirjen e një numri më të gjerë organizatash dhe aktorësh të interesit; - Të ftuarëve dhe pjesëmarrësve iu kërkua angazhimi për të përcjellë komentet dhe ndërhyrjet e tyre edhe në rrugë elektronike, si dhe çdo sugjerim për masa dhe aktivitete konkrete, të cilat do të diskutohen në takimimin e radhës të planifikuar për datën 17 mars 2026.

Stakeholder Feedback

Name:	Znj. Fabiola Egro	Organization/ Affiliation:	Anëtare e Komitetit Shumëpalësh të PQH, Shqipëri	Position:	
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
<p>Comments 1: Znj. Egro vlerësoi nismën e marrë dhe zhvillimin e këtij takimi për të rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen në hartimin e politikave më të mira.</p> <hr/> <p>Issues Raised: - Znj.Egro solli nevojën për të pasur sa më shumë konsultime dhe angazhime më reale. Vlerësoi Planin e kaluar të Veprimtimit shumë i mirë në letër, por sipas raportit të IRM, angazhimi dhe pjesëmarrja në zbatimin e OSHC-ve duhet të jetë më e qëndrueshme dhe e përmirësuar.</p>					

Znj. Egro, sugjeroi përfshirjen e qeverisjes vendore dhe për një qasje vertikale; Rrjeti për nxitjen e pjesëmarrjes së grave, vajzave, të rinjve të jetë më i përfshirë me dëgjesat publike.

Feedback:

Name:	Znj. Teisa Kurti	Organization/ Affiliation	Qendra A.L.T.R.I	Position: Koordinatorë Projekti
--------------	------------------	--------------------------------------	------------------	--

Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas

Comments: Znj. Kurti shprehu gadishmërinë për të bashkëpunuar dhe përfshirë në procesin e PKV për OGP.

Issues Raised:

1. Shtirja e trajnimeve për edukimin dhe ndërgjegjësimin kundër korrupsionit dhe nisja e punës për hartimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit edhe në nivel lokal;
2. Të shtohen bashkëpunime me organe të tjera, takime, trajnime, të avancojme me iniciativa në lidhje me uften Kunder Korrupsionit.

Feedback: -

Name:	Z. Vladimir Thano	Organization/ Affiliation:	Komiteti Shumëpalësh për	Position: Bashkë-kryetar	
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
<p>Comments: Z. Thano përgëzoi zhvillimin e takimit dhe pjesëmarrjen e këtij komponenti në këtë Plan të ri Veprimi.</p> <hr/>					
<p>Issues Raised:</p> <p>Z. Thano sugjeroi gjetjen dhe përfshirjen e mënyrave të zgjuara dhe eficiente në identifikimin e angazhimeve, sepse Plani Kombëtar i Veprimit të OGP, 2026-2030, ka afat të gjatë kohor, 4-vjeçar.</p> <hr/>					
<p>Feedback: -</p>					

Name :	Znj. Aranita Brahaj	Organization/ Affiliation:	Open Data Albania	Position: Drejtor Ekzekutiv	
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
<p>Comments:</p> <hr/>					
<p>Issues Raised: -</p> <p>Znj. Brahaj sugjeroi përfshirjen dhe parashikimin edhe të ndërmarrjeve shtetërore si pjesë e vlerësimit të riskut të korrupsionit dhe të parashikimit të masave për ndërhyrje.</p> <p>Të parashikohet njëprogram për më shumë transparencë në lidhje me procedurat, dhe se kush janë operatorët e IA në prokurime.</p> <p>Autoritete si: AP,P OBP, AKSHI janë 3 institucione që konkurrojnë. Kemi nevojë për metodologjinë e angazhimit të IA në këto procese dhe gjithashtu referuar informimit civil”.</p>					

Feedback: -

Name :	Znj. Rovena Sulstarova	Organization/ Affiliation:	IDM Albania	Position: Menaxher Programi per Qeverisjen	
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
<p>Comments: IDM punon referuar forcimit të integritetit publik dhe parandalimi i korrupsionit në proceset e vendimmarrjes. E dyta janë <i>state owned enterprises</i>, si sektorë vulnerabël ndaj korrupsionit dhe ndikimit politik. Sugjerojmë që Plani i Veprimt të ketë masa për Planet e Integritetit për <i>State Owned Enterprises</i>, edhe për monitorimin e tyre. Një tjetër mase, bashkëpunim me <i>IT</i> për hartimin e një metodologjie për aktet nënligjore të VKM.</p> <p>Vendi ka ligje shumë të mira, dhe ndonjëherë detajet fshihen ne aktet nënligjore dhe si e tillë le të kemi një instrument se si monitorohet procesi i akteve nënligjore.</p> <p>Diçka tjetër te ketë lidhjen me ligjin aktual me Lobimin, një masë mund të ishte promovimi i transparencës së regjistrimit të Lobimit, mund të bëjmë një adresim me një mase dhe ndaj të fokusohemi për të pasur një mase lidhur me zbatimin e ligjit të Lobimit.</p> <p>Lidhur me edukimin ligjor antikorrupsion, kemi bërë trajnime me nëpunësit, jemi angazhuar në trajnime në lidhje me këshilltaret e etikës në institucionet publike dhe jo vetëm në pushtetin lokal, por edhe në sistemin arsimor, dhe gjithashtu për trajnimin e mësuesve në këtë fushë ka rëndësi.</p>					
<hr/>					
Issues Raised: -					
<hr/>					
Feedback: -					

Name :	Rezarta Agolli	Organization/ Affiliation:	AWEN	Position: Drejtor Ekzekutiv	
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
Comments: Sugjeron vendosjen e vëmendjes për përmbajtjen e Planit të Veprimit për masa për prokuroritë dhe gjykatat me qëllimin mbrojtjen e interesave të personave që iu drejtohen.					
Issues Raised: -					
Feedback: -					

Name :	Blerta Kalavace	Organization/ Affiliation:	I.D.R.A	Position: Menaxher Programi	
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
Comments: Përgëzoi nisjen e procesit dhe thellimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile për vlerësimin e riskut të korrupsionit 5 sektorët e identifikuar nga SNKK dhe përtej tyre.					
Issues Raised: -					
Feedback: -					

Listëprezenca

Nr.	Emër Mbiemër	Institucioni
1	Rovena PREGJA	Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit
2	Ermelinda	EMA
3	Teisa Kurti	Qendra ALTRI
4	Daniel Prroni	IDM Albania
5	Aranita Brahaj	AIS (Open Data Albania)
6	Rezarta Agolli	AWEN
7	Klarisa CSDC	CSDC
8	Jona Alite	Partners Albania
9	Vladimir Thano	Bashkëkryetar i Komitetit Shumëpalësh të PQH Albania
10	Fabiola Egro	Anëtare e Komitetit Shumëpalësh të PQH Albania
11	Rovena Sulstarova	IDM Albania
12	Blerta Kalavace	IDRA
13	Anxhela Gjergji	-
14	Elida Jata	Qendra ALTRI
15	J.A	-
16	AWEN	AWEN
17	Hener Shanaj	DPAK
18	Artenisa Troksi	DPAK

Photos/ gallery

Stay in the know. Turn on desktop notifications.

16:46

Take control Chat People Raise React View Notes Apps More Camera Mic Share Leave

RP Rovena Prega QA Qendra ALTRI HS Hener Shanaj EE Ermelinda EMA AT

AGENDA_TAKIM 1_DGP_PLANI I VEPRIMIT 5 mars 2026.pdf

REPUBLICA E SHqipëRIE
BUREJTORIA E PËRGLITSHMË E ANTIKORRUPSIONIT

TRILIZË PUNË - KUNDËS TIM
PËR BASHKË-BËRJEJEN E PLANIT TË VEPRIMIT PQH (OGP) 2026 - 2030
Përballë Luftës Kundër Korrupsionit

Takimi 1: Diskutimi, bashkëfillimi i gjetjeve të përbashkëta hartuara në mesazhin
Planit të Veprimit 2026-2030

Takimi 1, mars 2026
Ora 13:00

13:00 - 13:05: Regjistrimi (përshkrimet)

13:05 - 13:10: Prezentimi dhe fjalë hyrëse

13:10 - 13:20: Ndërrimi i grupeve dhe diskutimi i përbashkët për angazhimin "Lufta kundër Korrupsionit" në grupet e punës të bashkëbërjes së Planit Kundra Korrupsionit 2026-2030

13:20 - 13:30: Diskutimi dhe propozimi nga të pranishmit. Ndalo dhe më të tre propozimet.

13:30 - 13:35: Përshkrimet e takimit dhe ndalo dhe më të tre.

13:00: Mbyllja e takimit.

Participants

Type a name

Share invite

In this meeting (6)

- AT Artenisa Troksi
- EE Ermelinda EMA
- HS Hener Shanaj
- ID IDM Info
- QA Qendra ALTRI - Teisa Kurti
- RP Rovena Prega

People added to the chat (1)

- SH Suada Hasalami

Stay in the know. Turn on desktop notifications.

30:25

Take control Chat People Raise React View Notes Apps More Camera Mic Share Leave

RP Rovena Prega QA Qendra ALTRI HS Hener Shanaj EE Ermelinda EMA DP Daniel Prroni EJ Elida Jata AT

Home Insert Draw Design Transitions Animations Slide Show Record Review View

Open Government Partnership

Qeverisja e Hapur për Shqipërinë (OGP)
Plani i Veprimit 2026-2030

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorupsionit
takim me OSHC
për bashkë-bërjen e Planit të Veprimit PQH (OGP) 2026 - 2030
Angazhimi: Lufta kundër Korrupsionit
Tiranë, më 5 mars 2026

Participants

Type a name

Share invite

In this meeting (14)

- AT Artenisa Troksi
- AC Anxhi CsdC
- AA Aranita Brahaj AIS
- A AWEN
- DP Daniel Prroni
- EJ Elida Jata
- EE Ermelinda EMA
- HS Hener Shanaj
- ID IDM Info
- PA Jona Alite, Partners Albania
- KC Klariša CSDC
- QA Qendra ALTRI - Teisa Kurti
- RA Rezarta Agolli AWEN

30:55

Take control Chat People Raise React View Notes Apps More Camera Mic Share Leave

Participants

Type a name

Share invite

In this meeting (13)

Mute all

- AT - Artenisa Troksi
- AA - Aranita Brahaj AIS
- A - AWEN
- DP - Daniel Prroni
- EJ - Elida Jata
- EE - Ermelinda EMA
- HS - Hener Shanaj
- IDM - IDM Info
- PA - Jona Alite, Partners Albania
- KC - Klarisa CSDC
- QA - Qendra ALTRI - Teisa Kurti
- RA - Rezarta Agolli AWEN
- RP - Rovena Prega

Qëllimi i takimit

Takimi 1:

Diskutimi, konsultimi mbi gjetjet e pyetësorit si bazë për bashkë-hartimin e Planit të Veprimit (lufta kundër korrupsionit)

clpaq

Stay in the know. Turn on desktop notifications.

Search (Ctrl+Alt+E)

Turn on

01:32:51

Chat People Raise React View Notes Apps More Camera Mic Share Leave

Activity

AT

Artenisa Troksi

Rovena Prega

Qendra ALTRI - Teisa Kurti

FE

Fabiola Egro

Rezarta Agolli AWEN

Elida Kalavace IDRA

HS

HS

Hener Shanaj

KC

Klarisa CSDC

1/2

Stay in the know. Turn on desktop notifications.

01:37:51

Chat People Raise React View Notes Apps More Camera Mic Share Leave

Activity

AT

Artenisa Troksi

Rovena Prega

Qendra ALTRI - Teisa Kurti

BI

Fabiola Egro

Elida Kalavace IDRA

IDM Info

HS

HS

Hener Shanaj

KC

Klarisa CSDC

A

AWEN

1/2



